



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:222032
Datë: 26.07.2024
Numri i dokumentit: 05984788

AC-I-24-0493

Në çështjen juridike të:

Paditësi-propozuesi/ankuesi

H H nga Podujeva, përfaqësuar nga av. F K, Prishtinë.

Kundër:

Të paditur - kundër propozues

1. R U(qiramarrës nga AKP-ja), N.T.P. "F" në Prishtinë.

2. N Z U(qiramarrëse nga qiradhënësi R U e N.T.P.

F, në Prishtinë.

3. Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. "Dritan Hoxha", nr.55, Lakrishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJSK), i përbërë nga Mr. Sc. Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Ilmi Bajrami gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të parashtruar kundër Aktvendimit të Shkallës së parë të DHPGJSK-së C-III.-22-0323, të datës 11 qershor 2024, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 25 korrik 2024, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

1. Ankesa e paditësit aprovohet si e bazuar.

2. Ndryshohet Aktvendimi i Shkallës së parë i DHPGJSK-së C-III.-22-0323, i datës 11 qershor 2024.

- 3. I ndalohet të paditurve R U, N Z U që të dy nga Prishtina (si qiramarrës nga AKP) dhe Agjencisë Kosovare të Privatizimit, ndryshimi i gjendjes së brendshme ekzistuese të njësisë- lokalit afarist me nr., lloji lokal afarist, në sipërfaqe 49 m², kati P, hyrja ., ZK Prishtinë.**
- 4. Kjo masë e sigurimit do të mbetet në fuqi deri sa Dhoma e Posaçme të merr vendim përfundimtar për padinë.**
- 5. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale:

Me 18 mars 2011 paditësi – propozuesi ka parashtruar padi posedimi për lirim dhe dorëzim në posedim të lokalit, i cili lokal gjendet në Prishtinë rr. “. ” në sipërfaqe prej 48.60m². Në padi ka theksuar se të drejtën e pronësisë në këtë lokal e ka fituar në bazë të kontratës së shitblerjes e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prishtinë me nr. VR.nr...të dt., kontratë kjo e lidhur në mes të pronarit të përhershëm – shitësit G P dhe paditësit H H si blerës. Çmimi i shitblerjes sipas kontratës është realizuar në tërësi mirëpo, dorëzimi në posedim nuk është bërë asnjëherë meqë ka qenë e uzurpuar nga persona tjerë ndërsa tani (viti 2011) e mban në posedim i padituri R U nën firmën N.T.P. “F”. Përkundër tentimit për marrëveshje për lirim e lokalit, nuk ka mundur të arrihet marrëveshja me arsyetimin se e mban me qira të marr nga Agjencia Kosovare e Privatizimit edhe pse sipas paditësit kjo nuk është pronë shoqërore por, ka qenë dhe është pronë private. Paditësi padisë i ka bashkangjitur kontratën shitblerjes së paluajtshmeris të lidhur në mes të shitësit P G dhe blersit-paditësit H H nga Podujeva e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prishtinë Vr.nr. ..të dt.. korrik., skicën lokalit, certifikatën për njësinë kadastrale ., leshur me dt..prill..

Me 17 nëntor 2015 AKP në cilësinë e ndërhyrëses ka përshtuar parashtresë dhe ka theksuar se ndërmarrja shoqërore “Duhani” në bazë të kontratës mbi shitblerjen e paluatshmerisë nr. 273 të dt. 24 shkurt 1989 është pronar dhe se nga ajo kohë ka ushtruar pushtetin faktik në kafit ligjore të pronësisë. Ka shtuar se me të paditurin ka lidhur kontrate të qirasë nr. ..të dt.. shkurt... AKP i ka bashkangjitur këto prova: Kontrata për qiranë e lidhur në mes të Ndërmarrjes shoqërore “Duhani” nr...të dt.. si dhe Pastiqeria “F” me objekt lokalit i cili gjendet në adresën rr.” .”

Prishtinë, në sipërfaqe prej 140 m², Mendimin e ekspertit të Gjeodezisë Q H dt.12 janar 2016

Gjykata Themelore në Prishtinë me aktvendimin e saj C.nr.514/11 dt.30.05.2016, është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore dhe lëndën ka vendosur që të ia dërgoj DHPGJS. Ndaj këtij vendimi ankesë ka paraqitur i autorizuari i paditësit, kurse Gjykata e Apelit e Kosovës me aktvendimin CA.nr.4170/2016 dt.12 shtator 2018 e ka refuzuar të njëjtën dhe e ka vërtetuar vendimin e Gjykatës Themelore.

Me 22 maj 2024, i autorizuari i paditësit - propozuesit në DHPGJS ka paraqitur Propozim për Caktim të Masës së Sigurisë, me të cilën ka kërkuar që të caktohet masa e sigurisë kundër të paditurve – kundër propozuesve N Z U si dhe AKP, ndryshimi i gjendjes së brendshme ekzistuese të lokalit afaristë N.P.T "F", i evidentuar sipas njësisë kadastrale .. në vendin e quajtur "Q" në sipërfaqe prej 43.9 m². Ka pohuar që lokali është në posedim të paditurës së parë e cila e ka marr me qira nga AKP dhe se paditësi i është drejtuar gjykatës për të kërkuar mbrojtje gjyqësore. E paditura – kundër propozuesja e parë ka filluar që të bëjë ndryshime duke e ndërruar gjendjen ekzistuese të lokalit, duke e bërë zgjerimin me disa lokale të tjera, e cila vërtetohet përmes fotografive. Me këto veprime do ti vështirësohet realizimi i të drejtës pronësore paditësit – propozuesit.

Gjykata ka dërguar Kërkesën për Caktimin e Masës së Sigurisë të paditurve – kundër propozuesve për përgjigje. E njëjta nuk ka arritur që ti dorëzohet të paditurve – kundër propozuesve të parë dhe të dytë, ku në të dyja rastet zyrtari i postes kishte konstatuar "objekt në renovim".

E paditura – kundër propozuesja e tretë AKP me 03 qershor 2024, ka paraqitur përgjigjen e saj ku ka deklaruar se e kundërshton propozimin e paditësit – propozuesit për lëshimin e masës së sigurisë duke e konsideruar si të pa pranueshme dhe të pa bazuar. I njëjti nuk e përmban bazën ligjore, nuk mbështetet në prova dhe nuk i ka bashkangjitur ndonjë titull juridik. Gjykatën e ka njoftuar se po bëhet renovimi i lokalit dhe jo tjetërsimi i tij. NSH "Duhani" ka lidhur kontratën e qirasë me Pastiçeri "F" e përfaqësuar nga N U si dhe ankesë kontratë nga

dt.01.11.2023 deri me dt.21.10.2024. Ka shtuar se paditësi nuk ka ofruar dëshmi të besueshme për kërkesëpadinë si dhe nuk janë përmbushur kushtet ligjore për lëshimin e masës së sigurisë. Gjykata i ka propozuar që të hedhet poshtë si i pa pranueshme propozimi për masë të sigurisë apo në të kundërtën të refuzohet si i pa bazuar.

Më 11 qershor 2024, Shkalla e parë e DHPGJSK-së ka marrë Aktvendim C-III-22-0323, me të cilin Kërkesa për Masë të Sigurimit, refuzohet si e pa bazuar dhe nuk caktohen taksa gjyqësore.

Shkalla e parë ka arsyetuar Kërkesa për masë të sigurimit është e pabazuar. Duke u bazuar në nenin 61 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, Dhoma e Posaçme mund të nxjerr një masë të sigurimit me kusht që parashtruesi të ofrojë prova të besueshme se do të ketë dëme të menjëhershme dhe të pariparueshme për palën nëse nuk miratohet masa e sigurimit. Dëmi konsiderohet si i pariparueshëm vetëm nëse nuk mund të zhdëmtohet në mënyrë të arsyeshme me anë të një kompensimi financiar. Paditësi i cila kërkon urdhër paraprak gjyqësor duhet të dorëzoj dëshmi të besueshme se: ekziston e drejta, dhe kjo e drejtë mund të dëmtohet në mënyrë të pariparueshme nëse nuk miratohet masa e sigurimit.

Barra e provës është tek paditësi, kështu që paditësi përveç që duhet të ofroj dëshmi të besueshme se e drejta e rrezikuar ekziston, duhet të ofrojë dëshmi dhe ta bëjë të besueshme faktin se do të shkaktohet dëm i menjëhershëm dhe i pariparueshëm, nëse nuk aprovohet kërkesa për masë të sigurimit. Shkalla e I-rë ka arsyetuar se pa paragjykuar zgjidhjen përfundimtare të këtij kontesti, vlerëson se paditësi në këtë stadë të procedurës, nuk ka dorëzuar dëshmi të besueshme se ekziston e drejta e pretenduar në favorin e tij, nuk ka dëshmi që tregojnë për të drejtat e tij mbi pronësinë e lokalit që është objekt i këtij kontesti. Po ashtu, në bazë të kontratës së qirasë e lidhur në mes të NSH "Duhani" dhe Pastiçeri "F", vërtetohet se lokali është marrë me qira nga e paditura e tretë si administruese me pasurinë e NSH-ve, dhe i njëjti lokal vërtetohet se gjendet në pronësi të NSH-së dhe jo të paditësit.

Tutje shkalla e parë ka arsyetuar se nuk është plotësuar as kushti për dëm të menjëhershëm për caktimin e Masës së sigurimit, pasi që paditësi nuk e ka paraqitur ndonjë rrethanë, nga e cila pritet të pësojë ndonjë dëm të menjëhershëm dhe se nuk ka dorëzuar dëshmi të besueshme se kjo e drejtë mund të dëmtohet menjëherë, nëse nuk miratohet kërkesa për masë të sigurimit.

Shkalla e parë ka vlerësuar se sipas dispozitave ligjore dëmi konsiderohet si i "pariparueshëm" vetëm nëse nuk mund të zhdëmtohet në mënyrë të arsyeshme me anë të një kompensimi financiar. Në rastin konkret, as kushti për dëm të pariparueshëm, si kusht për tu caktuar masa e sigurimit nuk është plotësuar.

Më 20 qershor 2023, paditësi/ankuesi – propozuesi ka parashtruar ankesë të aftashme nëpërmjet përfaqësuesit kundër aktvendimit të Shkallës së I-rë C-III-22-0323 të datës 11 qershor 2023, për shkak të shkeljeve esencial të dispozitave ligjore, vërtetimit të gabuara dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së të drejtës materiale, duke propozuar që të aprovohet ankesa si e bazuar ashtu që të anulohet aktvendimi i atakuar, lënda të kthehet në rishqyrtim ose në rivendosje apo të ndryshojë vendimin ashtu , që të aprovohet kërkesën për caktimin e masës së sigurisë, për njësinë kadastrale -.,, ne sipërfaqe prej 49 m2 dhe duke i ndaluar kundërshtarëve ndryshimin e gjendjes faktike të paluajtshmerisë.

Ankuesi në ankesë ka pohuar se Shkalla e parë e DHPGJSK-së me vendimin e ankimuar ka refuzuar kërkesën për caktimin e masës së sigurisë, me arsyet se nuk është bërë e besueshme se e drejta i takon paditësit/propozuesit; pronësia i takon të paditurës/kundërshtarit të tretë; nuk është argumentuar se veprimet e të paditurve/kundërshtarëve të parë do të shkaktonin dëme të pa riparueshme dhe veprimet e këtyre të fundit konsistojnë në dëme të pa riparueshme. Këto gjetje të Shkallës së parë janë kundërthënëse me vetveten, në kundërshtim me ligjin dhe në kundërshtim me provat materiale të paraqitura. Ankuesi e kundërshton konstatimin e shkallës së parë se pronësia i takon kundërshtares së tretë, AKP si administruese e pronave të NSH-ve, bazohet në pretendimet e të paditurës/kundërshtarit të tretë e jo në prova materiale.

Tutje ka shtuar se nga certifikata e pronësisë me numër referencë..., e propozuar si e tillë dhe e bashkangjitur në shkresat e lëndës, rezulton se paluajtshmëria,.. e

llojit lokal afarist, në sipërfaqe 49 m², kati P, hyrja., pronësi individuale e H H nga Podujeva, Rr."..". Kjo mbështet edhe në "informimin" nga AKK, me numër reference 03/2759/17, por edhe nga vërtetimi për pagimin e tatimit. Ndërsa lidhur me kushtin e dëmit të menjëhershëm, Shkalla e parë në përfundim edhe vetë konkludim se lokali është duke u rinovuar, natyrisht përmes dorëzuesit të shkresave, megjithatë ka konstatuar se të paditurit e parë nuk kanë ndërmarrë veprime në drejtim të tjetërsimit të tij.

Ky konstatim është i gabuar dhe kundërthënës ngase i padituri/kundërshtari R i'a ka bartur të drejtën (Qiranë) të paditurës/kundërshtares N, fakt ky i cili ka qenë i pa kontestueshëm. Megjithatë, ky konstatim i Gjykatës nuk përkon më kërkesën e propozuesit ngase i njëjti ka kërkuar që përmes masës t'u ndalohet kundërshtarëve ndryshimi i gjendjes faktike jo tjetërsimi.

Në këtë kuptim dhe lidhur me dëmin e pariparueshëm sqarojmë se është kusht i pa mundshëm për paditësin të provojë se cili është qëllimi apo rezultati final i punimeve të të paditurve të parë, duke pasur parasysh që propozuesi nuk ka qasje në lokal siç nuk ka pasur as dorëzuesi i gjykatës. Andaj faktin që të paditurit e parë nuk e kanë parashtruar përgjigje (pikërisht për këto arsye) dhe duke pasur parasysh deklaratimet joformale të të njëjtave se do të bëjnë renovimin dhe zgjerimin e lokalit, konsiderojmë se mbështetet mjaftueshëm pretendimi i propozuesit. Sikur që ky pretendim mbetet i pa kontestueshëm. Ankuesi ka theksuar se duke u bazuar në arsyet e cekura në ankesë konsideron se janë plotësuar kushtet nga neni 61 i Ligjit për DHPGJS dhe është e besueshme që drejta do i takojnë propozuesit dhe se pa caktimin e masës, të njëjtit do ti shkaktohet dem i pariparueshëm. Kushte këto të përpara edhe në dispozitat e LPK respektivisht nenit 297 e tutje.

Me 02 korrik 2024, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS përgjigjen ndaj ankesës, me të cilën ka propozuar që ankesa e paditësit të refuzohet si e pa bazuar dhe të vërtetohet aktvendimi i Kolegjit të Specializuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj. AKP-ja në ankesën e parashtruar ka theksuar se ankesa e paditësit nuk i përmbush kriteret të cilat kërkohen në bazë të nenit 66 të Ligjit nr.06/L-086 për Dhomën e posaçme sipas paragrafit 1.6 një kopje të aktvendimit që i nënshtrohet ankesës, si dhe argumentet ligjore të ankesës të paraparë me paragrafin 1.8.

Tutje ka shtuar se ankuesi ka atakuar aktvendimin për shkak, a) shkeljes së dispozitave të procedurës civile, b) Vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe c) zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Nuk qëndrojnë pretendimet paditësit mbi shkeljet e theksuara. Ankuesi as me ankesën e paraqitur kundër aktvendimit të Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme C-III-22-0323 paditësi nuk a arrite të paraqesë ndonjë bazë juridikë të besueshme dhe as nuk ka mundur të konstatojnë një gjendje tjetër faktike prej asaj siç e ka vërtetuar Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme me aktvendimin e lartcekur. AKP-ja konsideron se pretendimet ankimore të paditësit lidhur me atë se më aktvendimin e atakuar është bërë vërtetim i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike. Për AKP-në pohimet e tilla janë të pa bazuara dhe të paqëndrueshme për shkak se aktvendimi nuk është i përfshirë në shkelje të cilat pa të drejtë pretendon paditësi dhe asnjë shkelje të tjera. Paditësi përveç pohimeve, nuk ka ofruar asnjë dëshmi materiale apo bazë ligjore, me të cilën do të provonte se aktvendimi i atakuar është i kundërligjshëm. AKP-ja në përgjigjen në ankesë ka theksuar se paditësi ka parashtruar kërkesë për lëshimin e urdhrit paraprak gjyqësor, duke shtuar se është pronar i lokalit afarist sipas fletës poseduese -.,vendi i quajtur Qendër në sipërfaqe prej 43.9 m2. Nga kërkesa e parashtruesit sipas fletës poseduese – .-, vendi i quajtur Qendër në sipërfaqe prej 43.9 m2 ngastra në fjalë figuron të jetë në Dardani Rr."..", K-P, H-1, Nr.. Prishtinë duke figuruar në emër të R. K.. Ndërsa adresa e pretenduar ka të bëjë "Pasticeri F" me seli në Prishtinë, me adresë.., e jo ngastra e .. vendi i quajtur Qendër në sipërfaqe prej 43.9 m2 siç shihet paditësi është mundur ta vejë në lajthim gjykatën, me pretendimin se është pronar duke ju referuar ngastrës tjetër e cila është në emër të personit fizik. Si provë ka bashkangjitur: Propozimin e paditësit në shkresat e lëndës.

Tutje AKP-ja ka shtuar se ankuesi në ankesën e parashtruar ju ka referuar certifikatës së pronësisë me numër reference ., e propozuar si e tillë dhe e bashkangjitur në shkresa të lëndës, rezulton se palujtshmëria.., e llojit lokal afarist, në sipërfaqe prej 49 m2, pronësi individuale të H H nga Podujeva, Rruga".." , andaj për informim të gjykatës edhe kësaj radhe paditësi nuk ja ka bashkangjitur ankesës fletën poseduese siç është deklaruar me ankesë. Si provë e ka bashkangjitur ankesën e paditësit në shkresat e lëndës. AKP-ja e konteston ankesën e

paditësit/ankuesit dhe në mungesë të provave, ankesa e paditësit duhet të hedhet poshtë si e pa pranueshme. AKP konsideron se argumentet e theksuara janë të pa bazuar sepse mungojnë argumentet ligjore apo dëshmitë e përcaktuara sipas ligjit e që nënkupton se paditësi/ankuesi do të duhej të ofronte prova të besueshme që e drejta e pretenduar ekziston. Andaj konsiderojmë se pohimet e paditësit/ankuesit nuk e kanë vlerën e argumentit ligjor dhe si e tillë nuk mund të prodhojë ndonjë efekt juridik.

Më 11 korrik 2024, Gjykata ka lëshuar Urdhër për përfaqësuesin e paditësit nga i cili ka kërkuar që brenda afatit prej 5 ditësh nga dita e marrjes së këtij Urdhri ti sqarohet Gjykatës se a kërkon nga Gjykata të Caktohet Masa e Sigurimit për lokalin afarist, i cili evidentohet si njësi.., në sipërfaqe prej 49 m², kati P, Hyrja., ZK Prishtinë, apo kërkesë për masë të Sigurimit për njësinë kadastrale ..në vendin e quajtur Qendër në sipërfaqe prej 43.9 m².

Më 19 korrik 2024, Përfaqësuesi i paditësit i është përgjigjur Urdhrit të Gjykatës dhe ka theksuar se në kërkesën për masë të sigurisë të dorëzuar në shkallën e parë, është kërkuar të caktohet masa e sigurisë për njësinë..në vendin e quajtur Qendër në sipërfaqe prej 43.9 m², mirëpo kjo ka ndodhur për shkak të një gabimi teknik, ngase përgjatë procedurës, sipas aktvendimit të Agjencisë Kadastrale të Kosovës(AKK) të datës 23 prill 2013, është korrigjuar ky numër i njësisë se lokalit afarist, ashtu që numri i saktë është ky që e kemi kërkuar me ankesë pra njësia – lokali afarist me nr... Si provë ka bashkangjitur Aktvendimin e AKK të datës 23 prill 2013.

Me 11 korrik 2024, me urdhër ankesa e paditësit i është dërguara edhe të paditurave R U dhe N Z , ne mënyrë që ta të mund të paraqesin përgjigje në ankesë. Edhe pas përpjekjeve për dorëzim nga zyrtari i postës nuk ka arritur që ti dorëzohet të paditurave – kundër propozuesve të parë dhe të dytë.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e paditësit është e bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, është nuk saktë në rezultat dhe në arsyetim ligjor, andaj duhet të ndryshohet.

Nenit 61 të Ligjit Nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Ligji për Dhomën e Posaçme), Dhoma e Posaçme mund të nxjerr një masë të sigurimit me kusht që parashtruesi të ofrojë prova të besueshme për ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij dhe se do të ketë dëme të menjëhershme dhe të pariparueshme për palën nëse nuk miratohet masa e sigurimit. Dëmi konsiderohet sii pariparueshëm vetëm nëse nuk mund të zhdëmtohet në mënyrë të arsyeshme me anë të një kompensimi financiar.

Kërkesa për dëshmi të besueshme i përmban që të dyja: *fumus boni iuris* (propabiliteti se ekziston e drejta e kërkuar= presupozimi i bazës së mjaftueshme ligjore), dhe *periculum in mora* (rreziku i dëmtimit i pashmangshëm dhe i pariparueshëm ndaj kësaj të drejte), pasi që humbja dhe dëmtimi i drejtpërdrejtë dhe i pariparueshëm mund të ndodhë vetëm nëse ekziston në të vërtetë e drejta e pretenduar (shih jurisprudencën e përhershme të Kolegjit të Ankesave të DHPGJS-së: cf., *inter alia*, ASC-10-0079, ASC-10-0081, ASC-10-0017, ASC-10-0049, ASC-10-0088).

Me fjalë të tjera: paditësi/ankuesi i cili kërkon masë të sigurimit duhet të dëshmojnë probabilitetin se 1) ekziston rreziku i të drejtës të cilën e kërkojnë, dhe 2) e drejta është në rrezik të drejtpërdrejtë të humbjes ose dëmtimit të pariparueshëm, nëse nuk lëshohet masa e përkohshme e cila kërkohet.

Ankuesi në Shkallë të parë ka bashkangjitur kontratën shitblerjes së paluajtshmeris të lidhur në mes të shitësit P Gdhe blerësit-paditësit H H nga Podujeva e cila kontrate është e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prishtinë Vr.nr. ..të dt.. korrik .., skicën lokalit, si dhe certifikatën për njësinë kadastrale.., leshur nga Agjencia kadasatrale Kosovës me dt. 25 prill 2013. Nga kjo mund të përfundohet se paditësi ka një titull juridik dhe lokali kontestues në sipërfaqje prej 49 m2, kati nr. P, hyrja., evidentohet në kadastër emër të paditësit.

Për më tepër paditësit nuk mund të i kërkohet shkallë aq e lartë e propabilitetit për të drejtën për të cilën pretendon dhe ky është qëndrim konstant në jurisprudencën e Kolegjit të Apelit.

Kolagji i Apelit vëren se në këtë rast nuk është kontestuese fakti se kanë filluar punimet në lokal dhe se në çdo moment mund të ndryshoj gjendja ekzistuese e lokalit dhe me këtë rast do o vështirësohej paditësit ushtrimi i të drejtës së pretenduar pronësor. Madje sa i përket ndryshimeve dhe ndërhyrjeve në lokalin kontestues nuk është mohuara as nga ana e AKP-së. Zhdëmtimi nuk do të mund të bëhej në mënyrë të arsyeshme, nëse do të lejohej ndryshimi i gjendjes ekzistuese në lokal sepse paditësi që nga viti 2011 ka kërkuar lirim dhe dorëzimin e lokalit, andaj çdo lejimi i ndryshimeve të tilla para se të vendosej çështja meritore do të vështirësonte edhe me tepër zgjidhjen e këtij kontesti.

Kolegji i Apelit vlerëson se objekt i kontestit është i rrezikuar për shkak të veprimeve të paditurve me fillimin e punimeve dhe çdo ndryshim eventual mund të ndodhë, andaj në çdo kohë ajo duhet të mbrohet.

Kolegji i Apelit konsideron se Shkalla e parë e DHPGJS, nuk ka vendosur drejtë kur ka refuzuar kërkesën për masë të sigurimit pasi që kushtet e dhëna në nenin 61.1 të Ligjit për DHPGJS, janë përmbushur për këtë rast specifik, prandaj aktvendimi i ankimuar duhet të anulohet, ankesa duhet të aprovohet dhe të caktohet masa e sigurimit. Konstatimi i Shkalla e I-rë se paditësi në këtë stad të procedurës, nuk ka dorëzuar dëshmi të besueshme se ekziston e drejta e pretenduar në favorin e tij,

nuk është i drejtë, ngase paditësi siç arsyetua më lartë në këtë fazë të procedurës ka dëshmuara mjaftueshëm me prova për të drejtën e tij subjektive të rrezikuara.

Kolegji i Apelit ka marr në konsideratë çështjen e ngritura nga AKP-së së paditësi/propozuesi, ka parashtruar kërkesë për lëshimin e masës së sigurimit, për lokalin afarist sipas fletës poseduese -., vendi i quajtur Qendër në sipërfaqe prej 43.9 m², ashtu që me urdhrin e dt. 11 korrik 2024, Kolegji i Apelit ka kërkuar nga propozuesi i masës së sigurimit sqarimin se për cilën njësi kërkon masë të sigurimit.

Paditësi/propozuesi me parashtresën e dt. 19 korrik 2024, e ka sqaruar këtë dhe ka theksuar se ky gabim teknik kishte ndodhur si rezolutat i korrigjimit të njësisë së lokalit nga Agjencia Kadastrale e Kosovës ashtu që siç ka kërkuara me ankesë, kërkon caktimin e masës së sigurimit për njësinë – lokalin afarist me nr..në sipërfaqe prej 49 m², kati P, Hyrja., ZK Prishtinë. Si provë ka bashkangjitur Aktvendimin e Agjencis Kadastrale të Kosovës. Kolegji i Apelit vlerëson se nga shkresat e lëndës të dorëzuara në Shkallë të parë dhe nga provat e dozuara mund të kuptohet se kërkesa e paditësit kishte të bënte me caktimin e mase së sigurimit për lokalin- njësinë .. e jo për njësinë -., i cili kishte edhe sipërfaqe tjetër. Andaj për këto arsye pretendimet e AKP-së të ngritura në shkallë të dytë janë të pabazuara.

Kolegji i Apelit vlerëson se, nëse nuk caktohet masa e sigurimit, dëmi mund të jetë i riparueshëm për paditësin, pasi që atij do të i vështirësohet edhe më tepër gjendja e krijuar, apo nuk do të jetë e mundur të zhdëmtohet me anë të një kompensimi financiar brenda një afati të arsyeshëm.

Andaj nga se u tha më lartë, rezultati i dhënë me Aktvendimi i ankimuar, C-III-22-0323 i datës 11 qershor 2023 duhet të ndryshohet, ankesa e paditësit aprovohet si e bazuar, dhe të caktohet masa e sigurimit.

Ky Aktvendim në asnjë mënyrë nuk prejjudikon zgjidhjen përfundimtare të meritave të padisë.

Andaj, në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Taksa gjyqësore

Paditësi/ankuesi, e ka paguar taksën gjyqësore në shumë prej 100 euro, më 04 korrik 2024, sipas Udhëzimit administrativ Nr.01/2017 për Unifikimin e taksave gjyqësore andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

Lëshuar nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 25 korrik 2024

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues
